



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 22.11.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 20.11.2023 të parashtruar nga Operatori ekonomik " FATI SECURITY" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizimi, instalimi dhe servisimi i kamerave në shkollë", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-10931-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-159 -1-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " FATI SECURITY" SH.P.K, e dt.20.11.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi, instalimi dhe servisimi i kamerave në shkollë", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-10931-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-159 -1-2-1, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 14.11.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 14.11.2023;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anuloj aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.20.11.2023, Operatori Ekonomik " FATI SECURITY" SH.P.K, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Furnizimi, instalimi dhe servisimi i kamerave në shkollë", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-10931-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-159 -1-2-1.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 22.11.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja nuk qëndrojnë, sepse Autoriteti kontraktues gjatë fazës së vlerësimit ka vërejtur se është përvojë për një gabim tek specifikacioni teknik ku është përmendur një BRENDA i cili është në kundërshtim me nenin 19, paragrafi 19.8 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik:

19.8 Për aplikim të paragrafit 19.7 Autoritetet Kontraktuese duhet të sigurohen që paisjet, shërbimet dhe prodhuesit e specifikuar nuk i takojnë vendeve (shteteve) për të cilat Qeveria e Kosovës ka vendosur sanksione në import/eksport, ose vendeve, prodhimet, shërbimet dhe furnizimet e të cilave konsiderohen si të pabesueshme nga ndonjëra prej organizatave/vendeve, siç janë: Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, NATO, OECD ose Shoqata Evropiane për Tregëti të Lirë.

Në situatë të tillë , e vetmja rrugë për Autoritetin Kontraktues ka qenë anulimi i procedurës.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës